



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution**

---

## RAPORT

### I

## AVOKATIT TË POPULLIT

**A. nr. 474/2021**

**Arianit Dobroshi dhe të tjerët**

*përkitazi me pretendimet e ankuesve për diskriminim në bazë të lirisë së asociimit si anëtarë në Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës*

Drejtuar:

- Z. Bujar Ejupi, drejtor  
Autoriteti i Aviacionit Civil
- Z. Liburn Aliu, ministër  
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Për njoftim:

- Z. Habit Hajredini, drejtor  
Zyra e Kryeministrit- Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, më 9 qershor 2022

## Qëllimi i Raportit

1. Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Autoritetit të Aviacionit Civil (më tej: AAC) lidhur me nevojën e krijimit të hapësirës së mjaftueshme të veprimit për Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (më tej referuar si: shoqata sindikale), respektimin e lirisë së asociimit dhe gjetjes së gjuhës së përbashkët duke krijuar mundësi të përfshirjes së kësaj sindikate edhe në ndërtimin e politikave të institucionit pa i anashkaluar dhe diskriminuar ata.
2. Raporti bazohet në ankesën e parashtruar nga: znj. Zana Limani-Fazliu, z. Arianit Dobroshi, znj. Albulena Gërxhaliu, z. Arianit Islami, znj. Besnike Ukmata, z. Emir Hiseni, z. Granit Berisha, znj. Hysa Matoshi, znj. Lendita Kika Berisha, znj. Leonora Ibraj dhe z. Muhamed Luta (më tej: ankuesit), drejtuar në Institucionin e Avokatit të Popullit.

## Kompetenca e Avokatit të Popullit

3. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: *“Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”* Kurse në paragrafin 3 përcakton: *“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”*
4. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 1.2).
  - *“Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).
  - *“T’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).
  - *“Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 7).
  - *“Të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 8).
  - *“T’i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.”* (Neni 18, par. 1, nënpar. 9).

Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon t'i kryejë përgjegjësitë sipas dispozitave kushtetuese dhe ligjore të lartcekura.

### **Rrethanat e rastit**

5. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 23 korrik 2021 ka pranuar ankesën e znj. Zana Limani-Fazliu (e cila ka dhënë dorëheqje nga ACC-ja) dhe të tjerëve të deklaruar si anëtarë të shoqatës sindikale, si më lart.
6. Sipas pohimeve të ankuesve, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve në AAC, në tetor të vitit 2020 ishte formuar shoqata sindikale në të cilën ishin bashkëngjitur shumica e stafit profesional të këtij institucioni. Megjithatë, që nga njoftimi i punëtorëve të AAC-së për mbledhjen e kuvendit themelues të kësaj shoqate, kishin filluar presionet nga drejtori i përgjithshëm i AAC-së, drejtpërdrejt ose nga vartës të tij, për të mos u anëtarësuar e pastaj për t'u larguar nga sindikata, duke ua cenuar të drejtat në punë dhe duke ua mohuar të drejtën e organizimit sindikal.
7. Shoqata sindikale ishte regjistruar zyrtarisht në bazë të Vendimit nr. prot.199 të MPMS-së, datë 6 nëntor 2020.
8. Gjithashtu ankuesit kishin theksuar se në AAC kishte filluar procesi i riorganizimit të brendshëm, por nuk ishte përfshirë shoqata sindikale dhe me qëllim të qartësimit të çështjes në fjalë, më 1 dhjetor 2020 ishte mbajtur takim mes shoqatës sindikale dhe drejtorit të përgjithshëm të këtij institucioni. Në këtë takim, mes të tjerash, gjithnjë sipas pohimeve të tyre, përfaqësuesit e shoqatës sindikale kishin ngritur si shqetësim mospjesëmarrjen e ndonjë përfaqësuesi të tyre në grupin punues për riorganizimin e brendshëm, por drejtori i përgjithshëm, sipas ankuesve, kishte pohuar se nuk mund të ishin pjesë e këtij grupi për shkak se përbërja përcaktohej me ligje dhe me udhëzime, por kishte premtuar se do ta dërgonte draftin e rregullores për konsultim tek shoqata sindikale. Megjithatë ankuesit kanë thënë se një gjë e tillë nuk kishte ndodhur.
9. Për më tepër, ankuesit kanë thënë se dy anëtarë të shoqatës sindikale ishin larguar nga shoqata sindikale për shkak të frikës dhe presionit nga punëdhënësi dhe së paku në dy raste anëtarëve të kësaj shoqate u ishte thënë se nuk do të avancoheshin në pozita pune nëse nuk do të dilnin nga shoqata.
10. Më 25 nëntor 2021, znj. Zana Limani-Fazliu ka njoftuar përfaqësuesin e Avokatit të Popullit se ka dhënë dorëheqje nga ACC-ja dhe duke mos qenë pjesë e këtij institucioni pushonte edhe anëtarësimi në shoqatën sindikale dhe rrjedhimisht edhe funksioni si kryetare e shoqatës sindikale. Në njoftimin e saj ajo ka theksuar se ankesën e iniciuar tek Avokati i Popullit e kishte dorëzuar në rolin si kryetare e shoqatës sindikale dhe përfaqësuese e anëtarëve të saj dhe jo në cilësinë personale. Në këtë njoftim ajo më tej ka theksuar: *“Deri ne zgjedhjen e Kryetarit te ri nga Kuvendi i SPAAC, Arianit Dobroshti, i cili mban pozitën e Sekretarit do ta ushtroje detyren e Kryetarit dhe do ta perfaqesoje SPAAC dhe anetaret e saj, ne perputhje me nenin 3 te Statutit te SPAAC.”* Po ashtu ajo ka kërkuar që të gjitha komunikimet për këtë rast të zhvilloheshin me z. Arianit Dobroshtin.
11. Më 14 shkurt 2022, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka pranuar dokumente shtesë nga ankuesit, duke pretenduar për veprime diskriminuese ndaj anëtarëve të shoqatës sindikale nga ana e menaxhmentit të AAC-së. Sipas ankuesve, që nga themelimi i shoqatës

sindikale, menaxhmenti i AAC-së është duke ushtruar presion tek anëtarët e shoqatës sindikale duke i ftuar të njëjtët me qëllim të largimit nga anëtarësia. Sipas tyre, ka dyshime se dy anëtarë janë larguar tashmë nga frika dhe presioni dhe së paku në dy raste të tjera anëtarëve të shoqatës sindikale u është thënë që nuk do të avancohen në pozita pune nëse nuk largohen nga shoqata në fjalë.

12. Ankuesit kanë thënë se kjo praktikë e ndërhyrjes nga AAC-ja në shoqatën sindikale përbën shkelje të Ligjit nr.04/L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë, kurse Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton lirinë e asociimit dhe të organizimit sindikal. Prandaj ata pretendojnë se anëtarët e shoqatës sindikale janë të diskriminuar për shkak të anëtarësimit të tyre në këtë shoqatë, duke mos i dërguar anëtarët e shoqatës në trajnime profesionale, duke ua refuzuar pushimet vjetore, dhe në pesë muajt e parë të punës së drejtorit të përgjithshëm të AAC-së, gjashtë zyrtarë të këtij institucioni janë dërguar në komisionin disiplinor me pretendime për shkelje të rënda të punës, tre janë ndëshkuar dhe një zyrtari tjetër i është shqiptuar vërejtje me shkrim dhe këta janë të gjithë anëtarë të shoqatës sindikale në AAC.

13. Disa nga rastet sipas pretendimeve të ankuesve:

- Znj. Besnike Ukmata, në nëntor të vitit 2020, Komisioni Disiplinor në AAC kishte marrë vendim për masën e pezullimit nga puna pa pagesë, dhe pas tri javësh, largim të plotë nga puna, por përmes ankimit në KPMSHCK, me Vendimin A.nr.378/2020, e njëjta ishte kthyer në punë, megjithatë, sipas saj, pas kthimit në punë në janar 2021 i ishin shqiptuar dy vërejtje të tjera dhe pas shfrytëzimit të mjeteve juridike në dispozicion, çështja në fjalë është në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Gjithashtu ka thënë se dy herë i ishte refuzuar kërkesa për pushim vjetor, duke u vlerësuar ulët performanca e saj në punë. Megjithatë KPMSHCK-ja, përmes Vendimit A.nr.215/2022, datë 21 prill 2022, kishte aprovuar si të bazuar ankesën e znj. Ukmata kundër vlerësimit të punës për vitin 2021, pasi ajo kishte arritur objektivat e parapara në punë.
- Z. Arianit Dobroshiti, më 18 nëntor 2020, në kohën e themelimit të shoqatës sindikale, i ishte dhënë vërejtje me shkrim nga sekretari në AAC për dërgimin e një shkrese për përkthim pa aprovim të mbikëqyrësit, por që KPMSHCK-ja, përmes Vendimit A.nr. 374/2020, datë 11 janar 2021, kishte anuluar një vërejtje të tillë. Në këtë periudhë kohore z. Dobroshi ishte sekretar në shoqatën sindikale.
- Znj. Hysa Matoshi, anëtare e shoqatës sindikale, ishte dërguar në Komisionin Disiplinor në AAC për shkelje të kodit të etikës. Arsyeja ishte se znj. Matoshi kishte raportuar për një transferim të pozitës së punës, sipas saj, të paligjshme që kishte ndodhur në AAC, por që masa disiplinore ndaj saj ishte anuluar sipas Vendimit A.nr.420/2020 të KPMSHCK-së.
- Znj. Albulena Gërxhaliu, anëtare e shoqatës sindikale, kishte kërkuar nga menaxhmenti që të trajtohej ankesa e saj lidhur me pozitën e punës si inspektore me akt emërimi dhe me pagë ekuivalente, por që AAC-ja nuk kishte kthyer asnjë përgjigje dhe KPMSHCK-ja, sipas ankesës së parashtruar nga ankuesja, kishte marrë vendim që ta trajtonte çështjen në fjalë, por sërish AAC-ja nuk kishte bërë

një gjë të tillë dhe përfundimisht KPMSHCK-ja e obligon AAC-në ta ndryshojë akt emërimin.

- Z. Granit Berisha, sipas pohimeve të tyre, anëtar i shoqatës sindikale, në fund të vitit 2020 dhe në fillim të vitit 2021 ishte ftuar në zyre nga menaxhmenti i AAC-së dhe i ishte kërkuar që të largohej nga sindikata duke i premtuar që pastaj mund të ngrihej në detyrë kur të ndryshohet rregullorja e brendshme.
- Znj. Leonora Ibraj, anëtare e shoqatës sindikale, ka thënë se nuk i janë dhënë kredencialet e inspektoreve edhe pse ka përbushur të gjitha kushtet dhe ka vite që po e kryen detyrën e inspektoreve, ndonëse ka kaluar me sukses të gjitha kërkesat e nevojshme dhe ka parashtruar edhe kërkesë tek menaxhmenti i AAC-së për dhënien e kredencialeve në fjalë, por nuk ka marrë asnjë përgjigje, duke kaluar të gjitha afatet sipas procedurës administrative. Së njëjtës për dy muaj nuk i është siguruar kompjuter në zyrë që konsiderohet si mjet bazik i punës.
- Gjithashtu ankuesit kanë thënë se menaxhmenti në AAC kishte bërë vlerësimin e performancës së punës për vitin 2020 dhe se zyrtarët që janë anëtarë të shoqatës sindikale ishin vlerësuar me nota të ulëta, më pak se 3.6, kurse zyrtarët që nuk janë anëtarë të shoqatës sindikale ishin vlerësuar me nota më të larta nga 4.6 dhe 4.7. Tre anëtarët e shoqatës sindikale nuk ishin pajtuar me vlerësimin e performancës dhe kishin parashtruar ankesa në KPMSHCK dhe ankesat e tyre ishin pranuar si të bazuara pjesërisht dhe vlerësimin e performancës në punë për znj. Besnike Ukmata nga nota 2.1 nga menaxhmenti në AAC ishte bërë në 3.2, kurse për znj. Hysa Matoshi, nga 1.8 në 3.5, kurse për rastin e z. Arianit Islamit, sipas informacioneve të ankuesve, ende nuk i është bërë vlerësimi përfundimtar i punës në AAC, sikurse për vitin 2020, ashtu edhe për atë 2021.
- Për më tepër, ankuesit kanë thënë se anëtarëve të shoqatës sindikale në fjalë nuk u është ofruar mundësia e pjesëmarrjes në trajnime profesionale edhe pse tema kishte të bënte me përshkrimin e detyrave të punës. Ankuesit kanë pohuar se rastet konkrete kur nuk u janë ofruar mundësi të tilla të pjesëmarrjes në trajnime profesionale është në marsin e vitit 2021, Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil në Francë kishte ofruar nga dy vende falas për stafin profesional të AAC-së për t'i ndjekur dy kurse: *Teknikat e auditimit* dhe *Transporti ajror i qëndrueshëm* dhe ishte kërkuar nga menaxhmenti i AAC-së në Kosovë nominimin e zyrtarëve: znj. Besnike Ukmata dhe z. Granit Berisha, të cilët janë anëtarë të shoqatës sindikale, për të marrë pjesë dhe që janë të vetmit zyrtarë nga stafi profesional që nuk e kanë kryer trajnimin për teknikat e auditimit, por menaxhmenti kishte vendosur që në këto trajnime të merren pjesë zyrtarë të tjerë, që nuk janë anëtarë të shoqatës sindikale, dhe për më tepër nuk merren me auditime dhe as me punë profesionale të aviacionit. Megjithatë, Drejtoria e Përgjithshme e Aviacionit Civil në Francë ka kërkuar që t'i shihte CV-të e të propozuarve dhe ka refuzuar pjesëmarrjen e dy zyrtarëve të caktuar nga menaxhmenti i AAC-së për shkak se trajnimi, sipas tyre, është jorelevant për dy të propozuarit nga menaxhmenti i AAC-së. Gjithashtu ankuesit kanë thënë se edhe trajnimi tjetër profesional i ofruar falas nga AAC-ja në Francë, që ka të bëjë me transportin ajror të qëndrueshëm, menaxhmenti i AAC-së kishte propozuar dy zyrtarë që nuk ishin pjesë e shoqatës

sindikale dhe për cilët ky trajnim nuk ishte relevant, bazuar në përshkrimin e detyrave të punës së tyre.

14. Ankuesit kanë thënë se anëtarëve të shoqatës sindikale: z. Arianit Islami dhe znj. Lendita Kika Berisha, AAC-ja ua ka lëshuar vërtetimin e përvojës së punës sipas kërkesës duke mos e llogaritur gjithë periudhën kohore të punës, gjithnjë sipas pohimeve të tyre, me të vetmen arsye se ata janë pjesë e shoqatës sindikale në AAC.
15. Më 4 nëntor 2021, Avokati i Popullit i kishte dërguar shkresë drejtorit të përgjithshëm të ACC-së nga i cili kishte kërkuar informata përkitazi me pretendimet e ankuesve të theksuara më lart, përfshirë pohimet e tyre për diskriminim në bazë të lirisë së asociimit, në përputhje me nenin 20, par. 2, të Ligjit nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke i kërkuar dëshmi se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.
16. Më 19 nëntor 2021, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga udhëheqësja e Njesisë së Burimeve Njerëzore në AAC, sipas së cilës:

*“(...) Autoriteti i Aviacionit Civil ka gjithsej 30 punonjës, ndërsa shoqata sindikale e cila është themeluar nga një grup prej 10 nëpunësve të ACC-së që përbëhet nga 4 drejtorë departamenteve dhe 6 zyrtarë.”*

*“Nuk kemi informacion se ekzistojnë fakte për diskriminim të nëpunësve në mënyrë që AAC ti shjellon në ACC. Etiketimi i institucionit të ACC pa prezantim të fakteve dhe në mënyrë spekulative mund të dëmtoj imazhin e Institucionit.”* Sipas kësaj përgjigjeje: *“Shkeljet disiplinore në ACC trajtohen sipas rasteve dhe bazuar në shkeljet e përcaktuara sipas ligjit. Vendimet e KPMSHC janë zbatuar edhe pse në disa raste ACC ka kundërshtuar këto vendime në gjkatë dhe jemi në pritje të vendimeve të gjykatës.”*

Në këtë përgjigje theksohej: *“Pretendimet se ka pas diskriminim në gradime në avancime në detyrë janë të pabazuara, pasi që ACC në 3 vitet e fundit si dhe për vitin 2021 nuk ka të aprovuara nga MPA dhe as nga Ministria e Financave pozita të reja ose buxhet për ngritje në detyrë. Dhe si e tillë edhe nuk ka mundur të ndodhë, pra ka qenë e pamundura dhe jo nga AAC (...).”*

Ndërsa sa i përket procesit të përgatitjes së projekt-rregullores për organizimin e brendshëm të AAC-së, ajo ka theksuar se e njëjta *“(...) nuk është aprovuar asnjëherë dhe pas kalimit të projektligjit për ndryshimin e ligjit të AAC, procesi i riorganizimit do të fillojë sipas ligjit të ri.”*

Sa u përket trajnimeve, ajo në përgjigje ka theksuar: *“Trajnimet janë dhënë sipas departamenteve dhe nevojave për trajnim në përgatitjen e planit të trajnimeve dhe të gjitha trajnimet janë zhvilluar dhe përfitues nga trajnimet kanë qenë i gjithë stafi pa dallim (...).”*

## **Analiza ligjore**

17. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, paragrafët 2 dhe 3, përcakton: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”*

18. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24, përcakton: “Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim, askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhje kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.”
19. Kushtetuta, në nenin 44, paragrafi 1, përcakton: “Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.” Ndërsa paragrafi 2 përcakton: “Liria për të themeluar sindikata dhe për t’u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategori të veçanta të punonjësve.”
20. Neni 53 i Kushtetutës përcakton: “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.” Ndërsa neni 11, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton: “Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.”
21. Neni 14 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përcakton se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla, si: seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.
22. Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 2, përcakton fushëveprimin, sipas të cilit: “Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit, kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë avancimet, qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të avancuar profesional dhe rikualifikimet përfshirë edhe përvojën e punës praktike [...], çfarëdo të drejte tjetër të paraparë me legjislacionin në fuqi.”
23. Neni 3 përcakton konceptin e diskriminimit: “Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilësdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.” Ndërsa: “Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.” Kurse procedurat në organet kompetente, sipas nenit 12, përcaktojnë: “Çdo

*person apo grup i personave mund t'i parashtrojë ankesë Avokatit të Popullit lidhur me sjelljen diskriminuese mbi bazat e përmendura në nenin një (1) të këtij Ligji."*

24. Ligji nr. 04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare, neni 1, paragrafi 1, përcakton: "Ky ligj rregullon themelimin, regjistrimin, udhëheqjen e brendshme, veprimtarinë, shuarjen dhe çregjistrimin e personave juridik të organizuar si organizata joqeveritare në Kosovë." Ndërsa neni 3, paragrafi 1, përcakton: "Çdo person në Kosovë gëzon të drejtën e plotë për t'u asociuar dhe themeluar OJQ-në."; dhe paragrafi 2 përcakton: "Asnjë person nuk obligohet që të asociohet kundër vullnetit të tij dhe asnjë person nuk diskriminohet në asnjë mënyrë për shkak të vendimit për t'u asociuar apo për të mos u asociuar."
25. Ligji nr.04/L-011 Për Organizimin Sindikal në Kosovë, në nenin 2, par.1.4, me shprehjen "Liria sindikale" nënkuptohet si "e drejtë civile e të punësuarëve që të krijojnë dhe të bashkojnë organizata sindikale të cilat i organizojnë lirshëm aktivitetet, administrimin dhe veprimtarinë sindikale për të mbrojtur interesat e tyre".
26. Neni 4, par.2, përcakton që "Askush nuk duhet të jetë i diskriminuar, apo të cenohen të drejtat e të punësuarit për shkak të anëtarësimit, mosanëtarësimit në organizatë sindikale, për aktivitet sindikal në organizatën sindikale".
27. Neni 24, par. 1, përcakton se "Ndalohet diskriminimi ndaj përfaqësuesve të organizatave sindikale", kurse par.2 përcakton se "Për aktivitete sindikale, përfaqësuesit sindikal, pa pëlqimin e sindikatës nuk mund t'i:

- 2.1. ndërpritet kontrata e punës;
- 2.2. caktohet vend tjetër i punës;
- 2.3. ulet pozita e vendit të punës;
- 2.4. fillojë procedura disiplinore;**
- 2.5. zvogëlohet paga."

28. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i një vendi, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve që t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë.

29. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, kur flet për barazinë para ligjit, në mënyrë të qartë përcakton se të gjithë janë të barabartë dhe se askush nuk mund të diskriminohet sipas bazave të mbrojtura, përfshirë edhe në rastin konkret - sipas lirisë së asociimit, pasi legjislacioni në Kosovë ka mundësuar që lista e bazave të mbrojtura të jetë e pakufizuar dhe meqenëse është e tillë, edhe asociimi konsiderohet si bazë e mbrojtur. Për më tepër, sipas nenit 44, par. 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, liria e asociimit është e garantuar, kurse paragrafi 2 qartazi përcakton se liria për të themeluar sindikata dhe për t'u organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Në të gjitha kushtetutat e reja të vendeve të ndryshme patjetër garantohet e drejta e punëtorëve dhe e personave të tjerë të punësuar që lirisht të formojnë bashkime sindikale. Liria sindikale përfshin të drejtë për qasje në sindikatë pa diskriminim dhe që në të të veprohet lirisht.

30. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut ia garanton secilit lirinë e bashkimit me të tjerët, duke përfshirë edhe të drejtën e themelimit të sindikatës dhe të anëtarësimit në të me qëllim të mbrojtjes së interesave të veta<sup>1</sup>. Prandaj e pandashme nga liria e bashkimit është edhe liria e themelimit të sindikatës dhe e bashkimit, përkatësisht mosbashkimit sindikal.
31. Në nenin 5 të Kartës Sociale Evropiane është parashikuar e drejta e punëtorëve dhe e punëdhënësve për të formuar organizata lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e interesave të veta ekonomike dhe shoqërore e po ashtu edhe e drejta për negociata kolektive (shih nenin 6), që nënkupton se sindikatave duhet t'u mundësohet që të hyjnë në negociata kolektive që t'i mbajnë tubimet e tyre dhe t'u mundësohet qasja tek punëtorët.
32. Në rastin që po e trajton, ky raport, sipas pohimeve të ankuesve dhe dokumentacionit të dorëzuar në IAP, bëhet fjalë për largim të një anëtareje të shoqatës sindikale, punonjëse në AAC, ku menaxhmenti i këtij institucioni madje nxori Vendimin nr.2020/KD/322 për largim nga shërbimi civil të ankueses znj. Besnike Ukmata, vendim ky që ishte kontestuar në KPMSHCK, e cila me Vendimin A.nr.378/2020 e kishte kthyer atë në punë.

### **Konstatimet**

33. Avokati i Popullit konstaton se edhe pse liria e asociimit është e garantuar vërehet se ka munguar vullneti i shprehur për bashkëpunim me Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës. Mosbashkëpunimi krijon divergjenca dhe probleme me efekte zinxhimore.
34. Liria sindikale përfshin të drejtën për qasje në sindikatë pa diskriminim dhe që në sindikatë të veprohet lirshëm. Veprimet e menaxhmentit të AAC-së ndaj zyrtarëve anëtarë të shoqatës sindikale përveç që kanë efekt negativ tek ushtrimi i veprimtarisë sindikale, krijojnë frikë dhe pasiguri edhe tek zyrtarët e tjerë dhe pengojnë lirinë e asociimit.
35. Avokati i Popullit konstaton se zyrtarët e shoqatës sindikale, përfaqësuesit e tyre të angazhuar në negociata kolektive apo edhe anëtarët e sindikatës nuk duhet që për shkak të të qenët pjesë e sindikatës të kenë pasoja të dëmshme në formë të largimit nga puna apo masa të tjera të ushtrimit të presionit.
36. Avokati i Popullit konstaton se shoqatës sindikale në AAC duhet t'i sigurohet qasje e papenguar brenda fushëveprimit të saj në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të anëtarëve të saj dhe në rastin konkret AAC-ja duhet ta mbështesë shoqatën sindikale duke e promovuar si vlerë e shtuar në AAC.

Bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore.”* Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“(…) ka përgjegjësi të tërheq vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla (…);* si dhe: *“Të rekomandojë (…)* nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës.” (Neni 18, paragrafi 1.7),

<sup>1</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, neni 11.

## REKOMANDON

### Autoritetit të Aviacionit Civil:


- *Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës të ndërmarr të gjitha masat në respektim të drejtës së asociimit dhe organizimit sindikal pa as një pengesë ose masë që kufizon ose diskriminon anëtarët në organizimin sindikal .*
- *Të rritet niveli i bashkëpunimit me Shoqatën Sindikale të Punëtorëve të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës në ushtrimin e plotë të detyrave sipas qëllimit të themelimit dhe përmbushjes me sukses të funksionit për të cilin është krijuar.*
- *Në kuadër të hartimit të politikave të brendshme në Autoritetin e Aviacionit Civil, t'i mundësojë qasje edhe shoqatës sindikale në mënyrë që të dëgjohen edhe propozimet e sindikatës në politikëbërjen e institucionit.*

### Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës:

- *Brenda kompetencave të ushtrrojë mbikëqyrje në funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil, përfshirë gjendjen e krijuar në raportet sindikatë – udhëheqje e institucionit.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, përfshirë edhe masat disiplinore, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

  
Naim Qelaj  
Avokat i Popullit